



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim
dymujor
Viti X
Nr.63
Nëntor -
Dhjetor
2013

Roli i institucioneve lokale në adresimin e politikave të efijencës së energjisë

Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri mbajti një tryeze me temën “Roli i institucioneve lokale në adresimin e politikave të efijencës së energjisë” e ku mori pjesë edhe Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës.



FUQIZIMI I ZBATIMIT TË KONCEPTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE NË KOMUNAT E KOSOVËS



Këshilla për Kryetarin e Komunës

Doracak me këshilla drejtuar kryetarëve të komunave nga këndi i përfaqësuesëve të institucioneve e organizatave të ndryshme.

dhjetor 2013

Roli i institucioneve lokale në adresimin e politikave të efijencës së energjisë

Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri mbajti një tryeze me temën "Roli i institucioneve lokale në adresimin e politikave të efijencës së energjisë" e ku mori pjesë edhe Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Në këtë takim poashtu morën pjesë edhe Kryetari i këtij Komisioni Zenun Pajaziti, anëtarët e tij Sala Berisha –Shala, Shaip Muja dhe Myzejene Selmani, pastaj Fadil Ismajli, ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Leonora Kryeziu, drejtoresh e PIPS-it, Naser Sahiti, profesor në Universitetin e Prishtinës, Maliq Pireci, nga shoqëria civile, Luzim Sylja, përfaqësues i shoqatave për energji të ripërtrishme, Rinora Gojani nga INDEP-i. dhe Ilir Morina, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatë-

sisht kryeshef i Agjencionit për Mjedis.

Kryetari i komisionit, Zenun Pajaziti i siguroi të pranishmit se Komisioni do të angazhohet në ngritjen e efijencës së energjisë dhe se me përkushtim të veçantë do të monitorojë pakon e ligjeve që kanë të bëjnë me energjinë elektrike. Ndërsa ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli u shpreh se efijenca e energjisë është problem dhe çështje e pazgjidhur në nivel botëror. Ndërsa lidhur me angazhimet e MZHE-së, ai tha se ministria që ai drejton efijencën e energjisë e ka radhitur ndër prioritetet e para të kësaj fushe, e jo burimin e energjisë. Duke folur për ligjet, ministri Ismajli u ndal edhe te rëndësia e Ligjit për ndërtimet (ky Ligj është në fazën e amendamentimit), për të cilin tha se ka ndikim të drejtpërdrejtë në efijencën e energjisë.

Duke folur rreth kësaj teme, përfaqësuesi i Asociacionit të

Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, u fokusua në mosfunksionalizimin e zyrave për efijencën e energjisë në komunat e Kosovës. Sipas tij, shkak i kësaj gjendje është mungesa e buxhetit për punonjësit e këtyre zyrave, ndonëse komunat janë konsumuesit më të mëdhenjë publik të energjisë elektrike në nivel vendi. Ai foli edhe për realizimin e disa projekteve që kanë të bëjnë me këtë fushë, të realizuar me GIZ-in gjerman.

Për sa i përket zbatimit të ligjeve për energjinë, në vijim të debatit foli edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht udhëheqësi i Agjencionit për Mjedis, Ilir Morina. Ai tha se në përgjegjësinë e komunave bie barra më e madhe e zbatimit të këtyre ligjeve, gjë që shprehur në përqindje ajo arrin deri në 70%, tha ai. Ai po ashtu u angazhua për nevojën e një debati sa më të gjerë lidhur me këtë çështje.

AKK-ja publikoi Doracakun "Këshilla për Kryetarët e Komunave"

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim dhe mbështetje të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) sjellin para Jush doracakun "Këshilla për Kryetarin e Komunës". Ky doracak përmbledh letra në formë të këshillave të përfaqësuesve të institucioneve e organizatave të ndryshme, kryesisht të atyre që fushëveprimtaria e tyre gërshetohet me obligimet dhe përgjegjësitë e komunave.

Qëllimi i doracakut "Këshilla për Kryetarin e Komunës" është paraqitja e këshillave nga këndvështrimi i përfaqësuesve të institucioneve e organizatave të ndryshme për të adresuar sfidat e deritashme në qeverisjen lokale, ngritjen e respektimit të plotë të akteve ligjore dhe përmirësimin e shërbimeve komunale, por edhe si ndërlidhje me planet strategjike të komunave dhe nevojat e qytetarëve.

Ne falenderojmë përfaqësuesit e dhjetëra institucioneve dhe organizatave që kanë bashkëpunuar në këtë projekt, të cilët me idetë e këshillat e tyre do të ndihmojnë kryetarët e rinj të Komunave të dalë nga zgjedhjet e këtij viti.

Doracaku u është shpërndarë kryetarëve të Komunave ndërsa në formën elektronike mund të gjendet në ueb-faqen e AKK-së (www.komunat-ks.net)

FUQIZIMI I ZBATIMIT TË KONCEPTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE NË KOMUNAT E KOSOVËS



Asociacioni i Komunave të Kosovës finalizoi projektin "Fuqizimi i Konceptit të Mjekësisë Familjare në komunat e Kosovës". Qëllimet e Projekti ishin: Fuqizimin e konceptit të mjekësisë familjare përmes përcaktimit të listave të pacientëve dhe shndërrimit të Mjekësisë familjare në pikë hyrëse dhe koordinuese të kujdesit shëndetësorë për qytetarët; Rivitalizimi i shërbimeve të patronazhës / vizitave shtëpiake / infemierisë së komunitetit në kuadër të mjekësisë familjare; Zbatimi i shërbimeve të monitorimit dhe promovimit të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç; Zbatimi i shërbimeve shëndetësore miqësore për adoleshentë dhe të rinjë.

Ky projekt gjeti mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, projekt i cili u pilotua në komunat Prishtinë, Mitrovicë, Fushë-Kosovë, Obiliq dhe Dragash. Projekti synoi dhe arriti përcaktimin e planit aksional për fuqizimin e konceptit të mjekësisë familjare.

Në fillim të projektit u mbajt takimi me përfaqësuesit komunal (të pilotuara) nga Drejtoritë

Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe përfaqësuesit e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare në këto komuna me qëllimin për lansimin e koncept projektit, për të skanuar gjendjen në fushën e shëndetësisë sa i përket konceptit të Mjekësisë Familjare si dhe për të adresuar hapat e projektit.

Në fazën tjetër u përpilua një pyetësor që me pikat bazë të projektit i cili u shpërnda me komunat dhe rezultatet e tij janë pjesën aneks të këtij raporti përmbledhës.

Bazuar në shënimet e nxjerra nga pyetësorët dhe si synim të projektit, ekspertët përpiluan pesë draft-Rregullore për Komunat.

Draft Rregulloret e Projektit

Projekti ka prodhuar pesë Draft - Rregullore mbi fuqizimin e Konceptit të Mjekësisë Familjare në Komunat e Kosovës. Procesi i përpilimit të këtyre Draft-Rregulloreve ka qenë interaktiv dhe ka marrë për bazë parimet bazë të konceptit të Mjekësisë Familjare, nevojat dhe kërkesat e komu-

nave si dhe këndvështrimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Draft Rregulloret e përgatitura janë:

1. Draft - Rregullorja Komunale për Fuqizimin e Konceptit të Mjekësisë Familjare.
2. Draft - Rregullorja për referimi të brendshëm me theks të posaçëm në kujdesin për fëmijë.
3. Draft - Rregullorja mbi përshkrimin e punës së mjekut familjar/ekipit të mjekësisë familjare duke përfshirë edhe shërbimet komunitare.
4. Draft - Rregullorja mbi zgjedhjen dhe ndërrimin e mjekut familjar/ekipit të mjekësisë familjare.
5. Draft - Rregullorja mbi krijimin, ndryshimin dhe funksionimin e ekipeve të mjekësisë familjare.

Këto Draft-Rregullore do të jenë në dispozicion të Komunave për aprovim dhe fillim të zbatimit të tyre. Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Shëndetësi do të ndaj praktikat më të mira mes komunave në implementimin sa më të suksesshëm të këtyre Rregulloreve.

KËNDSHTRIMET**Dr.Valbon Krasniqi - Kryesuesi i Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Pesë vitet e kaluara ka qenë shumë e vështirë implementimi i Mjekësisë Familjare, duke pasur mungesë të stafit profesionist, mungesë të pajisjeve etj., ndërsa vitet e fundit shihet një përmirësim i dukshëm dhe shërbime më cilësore për pacientët, mirëpo ky koncept ende ka nevojë për përkrahje duke diagnostifikuar problemet si dhe duke pajisur QKMF-të me të gjitha mjetet e nevojshme për të ofruar shërbime sa më cilësore.

Dr.Genc Ymerhalili - Ministria e Shëndetësisë

Mangësi e konsideroj monitorimin apo vlerësimin për mbikëqyrje të drejtpërdrejt, edhe pse Ministria ka qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Komunitat. Është punuar në drejtim të unifikimit të Statuteve të QKMF -ve, por ende nuk është arritur unifikim, mirëpo do të duhej që unifikimi të realizohet, edhe pse kapacitetet e Komunave ndryshojnë dhe për shkak të kësaj ndryshueshmërie, dispozitat e përgjithshme të Statutit nuk do të duhej të ndryshohen. Ministria e Shëndetësisë është duke punuar në krijimin e Strategjisë Sektoriale dhe ideja qëndron në kujdesin parësor e cila reflekton në këto rregullore të draftuara nga AKK-ja. Një nga pengesat më të mëdha do të jetë edhe mos rritja e grantit specifik për shëndetësi, mirëpo nevojitet ende lobim tek Qeveria për rritjen e grantit specifik me qëllim të mbështetjes së kujdesit parësor.

Dr. Sami Uka - Koordinator nga Organizata Botërore e Shëndetësisë

Hapi i parë vetëm është hedhur, duke pasur bindjen se këto dokumente (Draft Rregulloret) mos të mbetën vetëm në letër, por të zbatohen edhe në praktikë. Involvimi i Ministrisë është shumë i nevojshëm që këto rregullore të zbatohen në të gjitha Komunitat e Kosovës. Ndërsa, pesë komunitat pilotuese kanë barrën më të madhe, sepse do të implementojnë këto rregullore dhe se do të jenë një model për Komunitat tjera, në të ardhmen, mirëpo shpresoj që të kenë përkrahje edhe nga Ministria e Shëndetësisë që ky proces të shkon më përpara.

Dr.Avdullah Hoti - Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - Prishtinë

Prishtina është specifike, ka shumë profile të shërbimeve primare / sekondare, por problemi më i madh është shfaqur se ky koncept nuk ka Udhëzim Administrativ dhe funksionon me Udhëzimin e vjetër administrativ, i cili ka shumë mangësi. Krahas, mungesës legjislative dhe respektimit të ligjeve janë shfaqur shumë probleme gjatë ofrimit të shërbimeve mjekësore si: matja e fëmijëve të moshës 0-5 vjeç (pesha dhe gjatësi), përcjellja e gjendjes së fëmijut deri në fund dhe gjithashtu mos përfshirja e mjekut familjar në kontakt me fëmijun. Përveç furnizimit me memografi në QKMF-Prishtinë është siguruar edhe stafi profesionist për përdorimin e memografisë dhe rentgenve për identifikimin e sëmundjeve të rënda.

Dr. Fevzi Sylejmani - Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - Mitrovicë

Ne kemi praktika pozitive për Komunitat tjera në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve, si dhe rritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore, sepse viteve të fundit kjo Komunitë ka arritur digjitalizimin e shërbimeve që ofrohen, teknikisht QKMF-të kanë zhvilluar anën teknike, ku grumbullohen të dhënat në mënyrë të sigurtë, rritjen e numrit të mjekëve për kokë banori, pajisjen e pacientëve me kartela shëndetësore, matjen e fëmijëve nga 0-5 vjeç, si dhe shumë shërbime të tjera.

Dr. Ramadan Jashari - Komuna e Dragashit

Në bazë të numrit të banorëve Komuna e Dragashit plotëson normën e mjekëve familjar për ofrim të shërbimeve, mirëpo problemi është i digjitalizimi i sistemit për ruajtjen e të dhënave, duke pasur parasysh se një numër i madh i banorëve janë në mërgim dhe të dhënat janë të mangëta krahas ofrimit të shërbimeve, pastaj pajisja me kartela shëndetësore, mungesa e furnizimit me vaksina, ku aktualisht është ndërpre vaksinimi si dhe mungesa e kriterëve bazë për alokimin e buxhetit në bazë të lartësisë mbi detare që ka Komuna e Dragashit.

Dr. Osman Maxhera - Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë

Ngarkesë tek ne është ofrimi i shërbimeve për qytetarët të cilët nuk i përjasin Komunitat, por janë të ardhur nga komuna e vendet tjera si dhe gjithashtu është e nevojshme ngritja e buxhetit e ndarja e nivelit të shërbimeve primare dhe sekondare.

Shëndetësia duhet të funksionoj në mënyrë unike si: përcaktimi i aktiviteteve, sistemi informativ shëndetësor, sistemi sekondar etj. Komuna e Fushë Kosovës kryen shërbimet e patronazhit mirëpo, problemet janë të shumta duke u nisur nga mungesa e veturës për vizita, mungesa e stafit, buxhetit, mungesa e vaksinave, kartelat shëndetësore, zëvendësimet të mjekëve etj.

Dr. Ymer Krasniqi – Drejtor i Shëndetësisë – Obiliq

Shqetësimet e komunës së Obiliqit janë të njëjta me komunat tjera si mungesa e buxhetit, mungesa e kartelave shëndetësore, vaksinimi, digjitalizimi etj, mirëpo rekomandoi që të mos bazohemi vetën në ofrimin e shërbimit për kokë banori, por edhe në bazë të ndërtimit të objekteve të cilat gjenden në Komunën e Obiliqit si : Termocentralet të cilat ndotin ambientin dhe numri i të sëmurëve është më i madh. Drejtoria e Shëndetësisë është duke planifikuar në rritjen e numrit të mjekëve, pasi që për momentin janë 9 (nëntë) mjek familjar, ndërsa numri i banorëve është 26,7 mijë (pa u inkuadruar komunitetin serb).

REZULTATET

- Adresimi për fuqizim të Konceptit të Mjekësisë Familjare nëpër Komunat e Kosovës.
- Përpilimi i Pesë (5) Draft Rregulloreve për Komuna në fushën e Mjekësisë Familjare;
- Hulumtimi dhe adresimi për zbatim i pikave kryesore për fuqizim të Konceptit të Mjekësisë Familjare në pesë komunat pilotuese.
- Zotimi i Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie

Sociale në hartimin (fillim (2014) e një Plani Operacional për të ngritur dhe zbatuar sfidat dhe ngecjet në komunat pilotuese të adresuara në hulumtimin e projektit.

- Përgatitja dhe nxjerrja e kësaj analize nga skanimi i gjendjes deri tek adresimi për përmirësim.

REKOMANDIMET

Gjatë procesit të implementimit të këtij projekti janë konstatuar disa ngecje dhe pengesa në fuqizimin e Konceptit të Mjekësisë Familjare nëpër Komunat e Kosovës, andaj komunat pilotuese (drejtorët komunal dhe përfaqësuesit e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare) kanë nxjerrë disa pika në formë rekomandimesh të cilat duhet kryer apo përmirësuar që të ketë avancim në fuqizimin e mjekësisë familjare nëpër komuna.

- Aprovimi i Rregulloreve nëpër Komuna;
- Implementimi i Rregulloreve të aprovuara;
- Krijimi i një Udhëzimi Administrativ nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me disa mungesa të bazës ligjore /përmirësimi i infrastrukturës ligjore;
- Digjitalizimi i sistemit të shërbimeve që ofrohen nga QKMF;
- Ndarja e nivelit të shërbimeve primare e sekondare, dhe si e tillë të jetë unike në të gjitha Komunat;
- Përmirësimi në mosvonimin e furnizimit të QKMF-ve me vakcina;
- Raportimi nga QKMF-të tek Ministria e Shëndetësisë (të ketë raportim unik dhe jo në mënyrë retroaktive);
- Rregullimi i sistemit të furnizimit me kartela shëndetësore për pacientët;

- Shqyrtimi i Ligjit për stomatologji;
- Organizimi i sesioneve edukative shtesë nëpër shkolla;
- Aplikimi i sigurimeve shëndetësore;
- Hartimi i Planit Operacional zbatues për komunat pilotuese nga Kolegjiumi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

HAPAT E ARDHSHEM

Kosova sivjet ka mbajtur zgjedhjet lokale, për çka ka pasur edhe vonesa në shtyrje në zbatim të dinamikës së projektit dhe disa pikave të tij. Në shumicën e komunave kemi ndryshime të strukturave qeverisëse.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në muajin janar dhe shkurt 2014 do të ri-konsolidoj strukturat e veta duke përfshirë edhe Kolegjiumin e Drejtorëve Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Përmes këtij mekanizmi dhe kryetarëve të Komunave do të llobojmë që këto Rregullore të miratohet në pjesën e parë të vitit dhe të filloj konkretisht zbatimin e tyre.

Komunat pilotuese (QKMF-të ne veçanti në këto komuna) do të inkurajohen përmes mekanizmave të veçantë të përmirësojnë pikat ku ku gjatë analizave dhe hulumtimeve tona (të cilat janë të paraqitura në pjesën e pasuese, sipas komunave veç e veç) ku kishte ngecje dhe probleme në zbatimin e plotë të Konceptit të Mjekësisë Familjare. Këto përmirësime do të përcillen nga Kolegjiumi i Drejtorëve Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, derisa në të njëjtën kohë do të ketë angazhim në shtrirjen e këtij koncepti edhe në komunat tjera.

Lajme nga Komunitat

DRENAS: Pyllëzohen 10 hektar me pishë të zezë

Komuna e Drenasit edhe këtë vit në bashkëpunim me Agjencionin Pyjor të Republikës së Kosovës, ka vazhduar me realizimin e projekteve për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura në territorin e Komunës sonë.

Në sezonin vjeshtor të këtij viti në vendin e quajtur "pishat e Gllanasellës", janë pyllëzuar edhe dhjetë hektar me fidanë të pishës së zezë, përkatësisht 25 mijë fidane të reja. Sipas drejtorit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik, Skender Hasi, pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura në Komunën tonë do të vazhdoj edhe në vitin e ardhshëm, ku janë planifikuar të pyllëzohen 20 hektarë me pishë të zezë në sektorin publik si dhe pesë hektarë në sipërfaqen të sektorit privat, ku ka një interesim të shtuar të fermerëve tanë për këtë kultivim të pishës së zezë.

KAÇANIK: Investitorët gjerman interesohen për investime

Dy kompanitë gjermane, "Mataks" me seli në Shtutgart që përfaqësohej nga menaxheri Karl Heinz E. Matt dhe kompania "BEO GmbH" me seli në Endingen, e cila përfaqësohej nga Clemens Sexauer, menaxher dhe Roman Bertram, ekspert softverik janë interesuar për hapjen e biznesit të tyre në komunën e Kaçanikut.

Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi e ka mirëpritur idenë për hapjen e biznesit ndërsa u ka propozuar zonën industriale në Kaçanik të Vjetër, si hapësira të mundshme për ndërtimin e objektit biznesor. Kryetari është shprehur i gatshëm se do të bëjë gjithçka që është e mundur për t'ua lehtësuar kushtet investitorëve, ndërsa i ka njoftuar investitorët se taksa komunale është zero. Ndërkaq, menaxheri i kompanisë "Mataks", z. E.Matt ka thënë se ideja jonë është hapja e një firme në Kosovë për zhvillimin e programeve softverike që nënkupton dizajnimin, menaxhimin, administrimin dhe bazat e të dhënave kryesisht në

Microsoft, për nevoja të doganave, shpeditoreve etj. Ai ka thënë se kompania e tij, përveç në Gjermani, është e shtrirë në shumë shtete të botës, ndërsa është në partneritet edhe me kompaninë "BEO GmbH" me të cilën duan të bashkëpunojnë edhe këtu. Z. E.Matt shtoi se përveç investimeve në programet softverike planifikohet që të investojnë edhe kompani tjera duke krijuar një zonë me aktivitete të përafërta ekonomike në sipërfaqen ekzistuese prej 5 hektarësh.

SKENDERAJ: Objekti i ri i komunës rritë efikasitetin e punës në shërbim të qytetarëve

Që nga lëshimi në punë i objektit të ri të administratës komunale, më 28 nëntor, qytetarët e Skenderajt po marrin shërbime më të shpejta dhe cilësore nga zyrtarët komunal. Objekti i ri i Komunës së Skenderajt është përfunduar më 28 nëntor dhe që nga ajo ditë shërbimet për qytetarë janë përmirësuar edhe më shumë. Kjo ka ndodhur pasi të gjitha drejtoritë dhe sektorët në kuadër të tyre tashmë janë në të njëjtin objekt. Të nëntë drejtorit komunale në fillim të punës janë angazhuar maksimalisht në akomodimin e stafit dhe krijimin e munësive për shërbime më të shpejta dhe cilësore.

Objekti i ri i administratës përveç që krijon kushteve shumë më të mira për shërbime më të shpejta dhe efikase për qytetarët, ai u ka ofruar edhe zyrtarëve komunal komoditetin e mjaftueshëm për punë cilësore.

Ndryshe deri në fund të nëntorit të këtij viti administrata komunale e Skenderajt ka punuar në tri objekte të ndara nga njëra tjetra dhe në gjendje jo të mirë. Objekti i ri i Komunës së Skenderajt është ndërtuar me financim të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunës së Skenderajt.

Lajme nga Komunat

ISTOG: Nga mbledhja e KKSB-së

Është mbajtur mbledhja e radhës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), kryesuar nga kryetari i Komunës z. Haki Rugova. Kryetari z. Rugova ka falenderuar dhe përgëzuar qytetarët Istogas për kontributin e tyre në mbarëvajtjen e Zgjedhjeve të 3 Nëntorit. "Falenderoj, para se gjithash, qytetarët e komunës së Istogut, Policinë e Kosovës si dhe të gjithë ata të cilët kontribuan që zgjedhjet lokale të kalojnë pa edhe më të voglin eksces. Ne vazhdojmë të qeverisim me komunën e Istogut dhe dua të ju siguroj se unë, ashtu siç isha, vazhdoj të jem kryetar i të gjithë qytetarëve të komunës së Istogut pa asnjë dallim politik, etnik, racor, fetar e tjera." Komandanti i Stacionit Policor në Istog, Toger Enver Gashi, ka prezantuar ngjarjet që kanë ndodhur në mes të dy mbledhjeve të KKSB-së, ndërsa z. Skënder Hasanxhekaj, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka njoftuar se janë bërë gjitha përgaditjet për sezonin dimëror për mirëmbajtjen e rrugëve dhe për raste eventuale emergjente.

SHTIME: Projekti i e-qeverisjes avansim i TI në komuna

Një ekip i OJQ-së "KS-KOSOVA", në përbërje Valon Hysenaj, Bujar Ejupi dhe Tringa Mullaademi kanë zhvilluar një takim me drejtorin e Administratës së përgjithshme z. Ekrem Reçica dhe përgjegjës për Teknologjisë Informative z. Miftar Miftari.

Në takim është diskutuar lidhur me identifikimin e opcioneve për vazhdimin e përkrahjes së komunave në zhvillimin e Programit të e-Qeverisjes, i cili parasheh krijimin e sistemeve elektronike për shërbimet e ndryshme të administratës dhe përparimin e Teknologjisë Informative (TI) në administratën komunale.

Drejtori z. Ekrem Reçica ka njoftuar përfaqësuesit e KS-Kosova se në komunën e Shtimes administrata funksionon mjaft mirë dukë shfrytëzuar sistemin e TI, i cili edhe u mundëson qytetarëve marrjen e shërbimeve në afatën sa më të shkurtër. Megjithatë, ai është shprehur se nevojiten ende veprime të ndërsjella me ministritë e caktuara për funksionalizimin e sistemeve të përbashkëta elektronike për shkakun që qytetarëve t'u shkurohet koha e pritjes së marrjes së një shërbimi. Me këtë

rast përmendi mundësinë e pagesave mbi 10€ në komunë, të cilën gjë qytetarët tani për tani nuk mund ta bëjnë dhe detyrohen të shkojnë nëpër banka, jashtë objektit të komunës, ku edhe duhet të paguajnë provizion.

Takimin e ka përshëndetur edhe kryetari i komunës, z. Naim Ismajli, i cili është shprehur i gatshëm të ndihmojë për çdo lloj risie që ka të bëjë me përparimin dhe avansimin e TI që do t'i kontribuojë shërbimeve më të shpejta për qytetarët.

HANI I ELEZIT: Inicohen aktivitete të rëndësishme të bashkëpunimit ndërkufitarë

Kryetari i komunës së Hanit të Elezit Rufki Suma, priti në takim punë Drejtorin e Agjensionit për Zhvillim Rajonal-Lindje, z. Almir Hysenin, Përfaqësues të Agjensionit për Zhvillim Rajonal të qytetit të Shkupit z. Lovren Markić, znj. Aneta Ravlinson, dhe Bekim Tronin, Drejtor i DUKMM nga komuna e Kaçanikut.

Temë e këtij takimi ishte bashkërendimi i aktiviteteve për bashkëpunim të mundshëm ndërmjet AZHR-Lindje nga Kosova dhe AZHR nga qyteti i Shkupit përkatësisht inicimi i veprimeve konkrete në përgatitjen e projekt-aplikacionit për të konkuruar për fondet parahyrëse të IPA-së të dedikuara për bashkëpunim ndërkufitarë.

Është në interes të dyanshëm që komunat fqinje në dy anët e kufirit të zhvillojnë bashkëpunim në shumë fusha të cilat do të kanë për objekt zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social, por krahas kësaj të kujdesen edhe për mbrojtjen e ambientit si dhe promovimin e resurseve dhe diversitetin natyrorë.

Në këtë pikë, palët në takim konsideruan se mbrojtja e Lumit Lepencë si resurs i rëndësishëm natyrorë është i përbashkët si palën Kosovare në këtë rast komunën e Hanit të Elezit dhe komunën e Kaçanikut por edhe për Regjionin e Shkupit.

Me aktivitete të përbashkëta ndërkufitare do të vendosej menagjimi i kualitativ i rrjedhës së Lumit Lepencë në përputhje me standardet e bashkimit Evropian por edhe ngritjen e vetëdijes publike, shoqërisë civile, sektorit privat, dhe të gjithë të interesuarve tjerë.



Meny

- > Dokumentet themelore
- > Aktiviteti Ndërkombëtar
- > Struktura Organizative
- > Komunat e Kosovës
- > Kryetarët e Komunave të Kosovës

Këshilli i Kryetarëve debaton pagat e zyrtarëve komunal me Ministrin e Administratës Publike



Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim të rradhës të Këshillit të Kryetarëve, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike z.Mahir Jaghillar lidhur me diskutimet për projektligjin për Pagat e Funkionarëve Publik në nivel të Kosovës

Shkurtimisht

- AKK-ja ka marrë pjesë në Konferencën regjionale dy ditore të organizuar nga UNICEF, me qëllim të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, duke përfshirë mundësitë e lancimit të shërbimeve në terren për shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Kosovë. Përfaqësuesi i AKK-së ka kontribuar në këtë Konferencë duke punuar në grup punues me disa përfaqësues të tjerë nga Komunat si: Obiliqit, Dragashit, Malishevës, Ferizajt dhe Prizrenit. Kjo Konferencë kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave nga vendet fqinje, dhe vende të tjera si: Bosnja Hercegovina, Kroacia, Italia, nga Britania e Madhe dhe Italia.
- AKK-ja po merr pjesë rregullisht në takimet e Këshillit të Përgjithshëm për Mirëqenie Familjare dhe Sociale dhe Këshillit për Turizëm.
- Në mbështetje të Programit GIZ/CDBE Kolegjiumi i Arsimit i AKK-së në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në ngritjen e kapaciteteve për përfaqësuesit e organizatave ofruese të shërbimeve trajnuese, ka organizuar një trajnim 2 ditor, në "Hartimin e Raporteve Hulumtuese". Në trajnim janë përfshirë përfaqësues nga 10 organizata të komunave të ndryshme të Kosovës.
- AKK-ja ka organizuar takim të pestë me radhë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor- ku ka përmbyllur me sukses realizimin e planit të punës për vitin 2013.
- AKK-ja po shqyrton të gjitha aktet ligjore që janë në procedurë të shqyrtimit gjatë periudhës së debatit publik.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
BULETINI

Viti X. Nr. 63 • Nëntor - Dhjetor 2013

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

